

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Brighton vendos rekord historik në Ligën Premier me lojtarë nga 15 kombësi
ADRESA	https://albeu.com/sport/brighton-vendos-rekord-historik-ne-ligen-premier-me-lojtare-nga-15-kombesi/1014734/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:13:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:07:22 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9ce35c8974106c32fbde5aae8e57367a39588b59a1345583d4b16e5acc45c5b9
TEKSTI	64448c0465bc1e5fedfcd79fdabe5884037d76fd5057ecea61fc9d9b4717147
PAMJA	703bc187064bfafbb511115d55b10e1b4a04755eaff389c2f4410a22692b32d91

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f8e08ce69a96c50fa4b5889ce4b34e34e55702845a3d51819a48a488dbe45668
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f8e08ce69a96c50fa4b5889ce4b34e34e55702845a3d51819a48a488dbe45668>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Brighton vendos rekord historik në Ligën Premier me lojtarë nga 15 kombësi



Brighton & Hove Albion ka hyrë sërish në historinë e Ligës Premier. "Seagulls" mposhtën 5-0 Coventry Cityn e drejtuar nga Frank Lampard dhe, krahas triumfit të thellë, regjistruan një rekord të veçantë në elitën e futbollit anglez.

Për herë të parë në historinë e Ligës Premier, një skuadër aktivizoi brenda së njëjtës ndeshje futbollistë që përfaqësonin 15 kombësi të ndryshme.

Trajneri gjerman Fabian Hürzeler e nisi takimin me një formacion të përbërë nga lojtarë të 11 kombësive. Portieri ishte holandezi Bart Verbruggen, ndërsa në mbrojtje luajtën turku Ferdi Kadioglu, kroati Luka Vuskovic, anglezi Lewis Dunk dhe francezi Olivier Boscagli.

Reparti i mesfushës përbëhej nga gjermani Pascal Gross dhe suedezi Yasin Ayari. Në fazën sulmuese u aktivizuan paraguajani Diego Gómez, Malick Yalcouyé nga Bregu i Fildishtë, belgu Maxim De Cuyper dhe greku Charalampos Kostoulas.

Gjatë pjesës së dytë, mozaikut shumëkombësh të Brightonit iu shtuan edhe katër përfaqësi të tjera. Në lojë hynë spanjoli Chema Andrés, ganezi Ibrahim Osman, portugezi Costinha dhe danezi Matt O'Riley.

Me këto zëvendësime, numri i kombësive të përfaqësuara në fushë nga Brightonit arriti në 15. Përfshirja e vetëm ishte Pascal Struijk, i cili përfaqëson Holandën njësoj si Verbruggen dhe zuri vendin e Vuskovicit.

Pjesëmarrja e Chema Andrés në arritjen e këtij rekordi i jep një domethënie të veçantë ngjarjes edhe për futbollistin spanjoll, pjesë e projektit të Brightonit.

Kjo përzierje kombësish mund të përshkruhet figurativisht si një "Kullë e Babelit", shprehje që përdoret për vende ose situata ku ndërthuren shumë gjuhë, kultura dhe kombësi, duke e bërë komunikimin të duket më të ndërlikuar.

të fundit /

- ÇLIRIMTARËT** Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së, KASH shpreh zhgënjim...
- Jashari apelon për qetësi dhe maturi, kërkon zhbërjen e...
- Prëzohet një avion i vogël në Alpet Zvicerane, humbin...
- Hetimet për dosjen Balluku dhe arredimin e vilës luksoze, arkitekt...
- Prokuroria kërkon zgjatjen e paraburgimit për të akuzuarin për...
- Protesta në Hagë, policia holandeze njofton për dy të...
- Vendimi ndaj komandantëve të UÇK-së, Nik Gjelošaj: Një...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Filozofia që ndjek Brighton për evidentimin dhe afrimin e talenteve ishte shpjeguar më herët për BBC nga pronari i klubit, Tony Bloom.

Bloom ka thënë se klubi i kërkon talentet në të gjithë botën, përfshirë Amerikën e Jugut, Azinë dhe vende të tjera të Evropës. Sipas tij, synimi është gjetja e lojtarëve më të mirë të mundshëm, të cilët përputhen me profilin e kërkuar për moshën dhe pagën, pa pasur rëndësi vendi nga vijnë. Ai e ka cilësuar këtë qasje si arsyen pse në dhomën e zhveshjes gjenden kaq shumë kombësi.

Diversiteti tashmë është kthyer në një tipar dallues të Brightonit, ndërsa një shembull domethënës është vetë Hürzeler. Trajneri 33-vjeçar zotëron tri shtetësi: gjermane, zvicerane dhe amerikane.

Hürzeler ka deklaruar se skuadra ka thellësi të mirë dhe se gjithmonë do të prezantohet përmes unitetit të saj.

Kështu, fitorja ndaj Coventryt jo vetëm që solli një rezultat bindës, por i dha Brightonit edhe një rekord të pazakontë në historinë e Ligës Premier, duke përforcuar diversitetin si një prej veçorive kryesore të klubit.

Shtuar më 16.09.2026 18:07

Tags: Brighton , Premier League



Dënimi me 81 vite burg nga Gjykata e Hagës, Vora mbështet ish-drejtnesit e...



Klopp përgatit surprizën e parë të Gjermania, fton futbollistit që 15 muaj më...



Kategoria e Parë zbret në fushë me 6 ndeshje, ja rezultatet LIVE të javës s...




Arsenali vijon ndjekjen e yllit të Real Madridit, bisedimet në prapaskenë...



Akuzat për trukum ndeshjes ndaj Alban Xhaferit, presidenti i...



Natë për t'u harruar për Ronaldon, Al Nassr pëson disfatë 4-0 dhe portugezi...



Toni Kroos ironizon tre yjet e Gjermanisë: "Në Botëror nuk u vunë re



Milani ndjek situatën e Brahim Diaz, largimi nga Real Madridi mund të...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com